

# RELACION

## PËR

### **PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE SHOQËRIVE “S2 ALBANIA”, SH.P.K., DHE “RAPISCAN SYSTEMS”, INC, “PËR NJË NDRYSHIM NË MARRËVESHJEN E KONCESIONIT PËR FINANCIMIN, NGRITJEN DHE OPERIMIN E SHËRBIMIT TË SKANIMIT TË KONTEJNERËVE E AUTOMJETEVE TË TJERA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, MIRATUAR ME LIGJIN NR.123/2013”, TË NDRYSHUAR”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Me qëllim zbatimin e akteve normative të Këshillit të Ministrave, nr.15/2020 dhe nr.28/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar”, si rrjedhojë e situatës së pandemisë Covid-19, në zbatim të të cilave u miratuan dhe aplikuan një sërë shkurtimesh drastike të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, midis të cilave u pakësua edhe pagesa koncesionare e vitit 2020 për Rapiscan në masën 400 mln lekë, ministri i Financave dhe Ekonomisë, me urdhrin nr.101, datë 30.4.2020, ngriti grupin e punës i cili do të hynte në negociata për rishikimin e marrëveshjes së koncesionit si rrjedhojë e pasojave të shkaktuara nga situata e pandemisë Covid-19, duke arritur një dakordësi lidhur me shtyrjen e kësteve të pagesës së marrëveshjes së koncesionit.

Qëllimi i këtij projektligji është lehtësimi i barrës financiare/buxhetore në buxhetin e vitit 2020 domosdoshmërisht, por edhe në nivel afatshkurtër të buxhetit 2021 e përtej nga situata e krijuar nga pandemia.

Me anë të shkresës nr.559 prot., datë 15.05.2019, protokolluar në MFE me nr.8680, datë 15.5.2020, shoqëria koncesionare “S2 Albania” ka sjellë pranë MFE propozimin për shtyrjen e tarifës së shërbimit të koncesionit jo te plotë (shtyrje 50 % për muajt korrik, gusht dhe shtator, nga Tarifa Vjetore e Shërbimeve të Pikës së Operimit për vitin 2020) dhe gatishmërinë e saj shtyrjen e tarifës së shërbimit të koncesionit për të asistuar në rimëkëmbjen e qeverisë shqiptare pas Covid-19.

Pas shqyrtimit të këtij propozimi nga MFE-ja, kjo e fundit ka vlerësuar se për shkak të situatës të krijuar nga Covid-19, shtyrja me 50% e pagesës së çdo kësti mujor të tarifës së shërbimit të secilës pikë operimi për muajt korrik - gusht - shtator nga Tarifa Vjetore e Shërbimeve të Pikës së Operimit për vitin 2020, qeveria shqiptare do të përballej me një vështirësi buxhetore për vitin 2021-2022, nëse do të pranonte këtë skenar.

Me anë të shkresës nr.579 prot., datë 9.7.2020, shoqëria koncesionare “S2 Albania”, sh.p.k. ka përcjellë propozimin e saj të dytë për shtyrjen e tarifës së shërbimit të koncesionit “Për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve dhe automjeteve të tjera”, i cili konsiston në shtyrjen me 50% të pagesës së çdo kësti mujor të tarifës së shërbimit të secilës pikë operimi për muajt gusht, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor nga Tarifa Vjetore e Shërbimeve të Pikës së Operimit për vitin 2020.

Ky propozim i shoqërisë koncesionare, pas analizimit nga MFE-ja rezultoi i pamjaftueshëm financiarisht për buxhetin e shtetit pasi rezultoi i ngjashëm me propozimin e parë por në një shtrirje kohore më të gjatë. Në këtë kuadër MFE-ja kërkoi sërish vinjimin e negociatave në mënyrë që të gjendej një propozim i arsyeshëm për të dyja (2) palët duke marrë në konsideratë situatën e shkaktuar nga pandemia COVID-19. Për këtë arsye, me anë të shkresës nr.20451 prot., datë 29.10.2020, i është komunikuar shoqërisë koncesionare një propozim për shtyrjen e pagesave në masën 100% dhe jo 50% sa ka propozuar koncesionari, pasi Këshilli i Ministrave përmes akteve normative të sipërcituara, për shkak të situatës së pandemisë nuk ka akorduar fond pagesash për muajt e mbetur të vitit 2020.

Në vijim të procesit të negociimit të kontratës së koncesionit me anë të shkresës nr.626 prot., datë 20.11.2020, protokolluar në MFE nr.20451/1, datë 20.11.2020, shoqëria koncesionare ka përcjellë propozimin, si më poshtë vijon:

Shtyrjen me 100% të pagesës së çdo kësti mujor të tarifës së shërbimit të secilës pikë operimi për muajt shtator, tetor, nëntor nga Tarifa Vjetore e Shërbimeve të Pikës së Operimit për vitin 2020 si dhe shtyrjen e pagesës së këstit të prapambetur në muajin gusht dhe mosaplikimin e penaliteteve apo të interesave mbi këto këste.

Në përfundim, grupi negociator u dakordësua me përfaqësuesit e koncesionarit sipas propozimit të përcjellë nga shoqëria koncesionare me anë të shkresës nr.626 prot., datë 20.11.2020, protokolluar në MFE me nr.20451/1, datë 20.11.2020.

Në përputhje me kontratën ekzistuese në fuqi, sipas ligjit nr.123/2013, të ndryshuar, kjo marrëveshje amenduese duhet të miratohet sipas Kushtetutës dhe ligjit në Kuvendin e Shqipërisë.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Miratimi i këtij projektligji nuk është i planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Me anë të këtij projektligji synohet të arrihet një ulje e lehtësim i barrës financiare/buxhetore në buxhetin e vitit 2020 domosdoshmërisht, por edhe në nivel afatshkurtër të buxhetit 2021 e përtej. Kjo gjë do të bëhet e mundur duke i lejuar autoritetit shtyrjen me 100% të pagesës së çdo kësti mujor të tarifës së shërbimit të secilës pikë operimi për muajt shtator, tetor, nëntor nga Tarifa Vjetore e Shërbimeve të Pikës së Operimit për vitin 2020 (në vijim referuar si “Periudha e Shtyrjes”). Gjithashtu, do të kemi një shtyrje të shlyerjes së detyrimit të mbetur nga kësti i muajit gusht për tarifën e shërbimit të një pike operimi, aktualisht në vlerën e papaguar 211,970 € nga e cila po të zbritet vlera e tarifës së koncesionit prej 2% e këtij kësti, vlera e mbetur e kësaj periudhe është 207,731€. Pagesa e shtyrë në masën 100% të kësteve për periudhën shtyrjes së bashku me këstin e prapambetur të gushtit do të shlyhen duke filluar nga data 1 janar deri më 31 dhjetor 2022 (pra, gjatë një periudhe 12-mujore) (Periudha e shlyerjes).

Kjo pagesë e shtyrë në masën 100% (në vlerën 3,354,859 €) për periudhën e shtyrjes së bashku me këstin e prapambetur të gushtit do të paguhet në mënyrë proporcionale në vlerën 279,572€ çdo muaj, mbi këstin e rregullt mujor të tarifës së shërbimit të secilës pikë operimi që është pjesë e tarifës vjetore të zbatueshme të pikës së operimit gjatë periudhës së shlyerjes. Gjithashtu, shoqëria koncesionare “S2” nuk do të aplikojë penalitete ose kamatëvonesa për vonesat e kryerjes së pagesave të parashikuara në këtë pikë.

## **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është mbështetur në nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, si dhe miratimi i këtij projektligji është në përputhje me legjislacion kombëtar dhe ndërkombëtar.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektligji nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të BE-së.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Në nenin 1 përcaktohet miratimi i marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “S2 Albania”, sh.p.k., dhe “Rapiscan Systems”, INC, “Për një ndryshim në marrëveshjen e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.123/2013”, të ndryshuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2 parashikon hyrjen në fuqi.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji parashkon efekte financiare shtesë në masën 3 354 859 euro, në buxhetin e shtetit për vitin 2022.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**